



25 gusht 2017

KOMUNIKATË PËR MEDIA

MBLEDHJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË AKP-SË

Prishtinë – Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e tij të rregullt ku u diskutuan dhe u morën vendime të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe përmbylljen e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në vend.

Në fillim të mbledhjes, Bordi mbajti një minutë heshtje në nderim e respekt për ish kryeministrin e Kosovës, z. Bajram Rexhepi i cili vdiq ditë më parë si pasojë e një sëmundje të rëndë.

Në vazhdim të mbledhjes, Bordi i Drejtorëve diskutoi për valën e fundit të shitjeve të aseteve të ndërmarrjeve në likuidim me nr.34 që u realizua gjatë muajit të kaluar dhe me këtë rast aprovoi transaksionet e aseteve që ishin për shitje në tenderin publik, ndërkohë që aprovoi edhe listën me prona që do të tenderohen me Shitje të Aseteve nr.37 si dhe depozitat e tyre.

Bordi diskutoi për procesin e përcaktimit të statusit të ndërmarrjeve dhe pronave që konsiderohen në pronësi shoqërore dhe kërkoi nga menaxhmenti që të intensifikojë përpjekjet, në mënyrë që sa më parë që është e mundur të përfundoj ky proces me rëndësi. Agjencia, me kërkesë të Bordit, do të shfrytëzoj mundësitë përmes publikimeve në media brenda dhe jashtë Kosovës për të kërkuar dëshmi në lidhje me statusin e subjekteve juridike. Në këtë mbledhje si ndërmarrje shoqërore me vendim të Bordit u përcaktuan ndërmarrjet “Sharrdrvo-export” Shtërpce, dhe “Kooperativa Bujqësore Zadruga” Osojan, Istog.

Në takim u diskutua edhe për Strategjinë për Marrëdhënie me Publik dhe Media të AKP-së, me ç’rast Bordi e aprovoi këtë dokument me ndryshime dhe plotësime të udhëzuara nga ana e Bordit. Ndërkohë, u diskutua edhe për qiradhënie të pronave të ndërmarrjeve shoqërore, dhe në këtë kuadër Bordi aprovoi disa qiradhënie direkte të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim dhe disa qiradhënie të pompave të benzinës të shpallura përmes shpalljes publike me 07 qershor 2017. Agjencia i ka të publikuara në faqen e saj zyrtare në internet të gjitha detajet për qiradhënie dhe së shpejti do të azhurnoj këto informata, dhe informatat për tenderet tjera që ndërlidhen me pjesën operative të Agjencisë me qëllim që publiku të informohet saktë dhe me kohë.

Bordi poashtu miratoi Raportin me 7 kërkesa të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore tek shfrytëzuesit e tyre, sipas Ligjit në fuqi, proces ky i rëndësishëm për përmbylljen e likuidimit të NSh-ve. Gjithashtu, Bordi aprovoi listat finale të punëtorëve për 20 %, për publikim dhe shpërndarje të mjeteve për 4 ndërmarrjet në vijim: NSh “Barnatorja e Gjakovës”; NSh Kooperativa Bujqësore Leshani”; NSh Enti për Urbanizëm dhe Projektim



Engineering Prishtinë”; dhe NSh “Stacioni i Veterinës Shtërpçë”. Ndërkaq po në këtë mbledhje Bordi miratoi edhe raportet e shpërndarjes së përkohshme për kreditorët e katër NSh-ve në likuidim: “Talinoc”, “Sharr”, “Peja Turist”, “Zhupa”, në shumën prej 42,090.17 €. Bordi poashtu miratoi dy raportet rekomanduese të Komisionit për shqyrtimin e asetëve me karakter specifik ku me këtë rast u dha drita e gjelbër që të vazhdohet me negociata direkte për lëndët e trajtuara në këto dy raporte dhe në fund të procesit raporti përfundimtar të sjellet përsëri në Bordi për trajtim dhe miratim.

Bordi në këtë mbledhje miratoi plotësim ndryshimin e Procedurave të shitjes dhe Rregullave të tenderit për shitjen e asetëve të ndërmarrjeve shoqërore.

FUND